



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 mars 2020
Nr. ref.:RK1523/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI142/19

Parashtrues

Ge Group sh.p.k.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E.Rev.nr.9/2019, i 23 majit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania “Ge Group sh.p.k.” me seli në Prizren, e përfaqësuar nga Ruzhdi Berisha, avokat nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [E.Rev.nr.9/2019] të 23 majit 2019 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.238/2016] të 9 nëntorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, përmes të cilave pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe 21.4 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 shtator 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtare raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 8 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 5 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Bazuar në dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se më 10 nëntor 2008, parashtruesi i kërkesës dhe Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit (në tekstin e mëtejme, MTPT) kishin lidhur një kontratë pune për ndërtimin e rrugës Polisht-Hoqë e Qytetit-Jeshkovë në vlerë prej 599,808.24 euro. Me qëllim të ndërtimit të rrugës në fjalë, parashtruesi i kërkesës kishte kontraktuar gojarisht kompaninë "NEPB Etem Trade" nga Prizreni me qëllim të furnizimit me material dhe gërmime të dheut sipas dinamikës së punës që parashihej me kontratën e lidhur me MTPT-në.

10. Për shkak të mosmarrëveshjes lidhur me punët që duhej kryer, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër kompanisë “NEPB Etem Trade” duke kërkuar që për shkak të pasurimit të pabazë kompania në fjalë t’i paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 43, 536, 55 euro me kamatë vjetore në lartësi prej 4%. Kompania “NEPB Etem Trade” ishte përgjigjur se kërkesa në të holla e parashtruesit të kërkesës ishte parashkruar.
11. Më 17 mars 2016, Gjykata Themelore me Aktgjykim [III.C.nr.650/2013] e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe detyroi “NEPB Etem Trade” që ta paguaj shumën prej 43, 536, 55 euro me kamatë ligjore brenda afatit shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Gjykata Themelore, mes tjerash kishte konstatuar: (i) se pala e paditur “NEPB Etem Trade” për një kohë të gjatë kishte dështuar që parashtruesin e kërkesës ta furnizojë me materiale dhe punë të kryera; (ii) se parashtruesi i kërkesës ishte detyruar të gjejë kontraktor tjetër për realizim të kontratës me MTPT-në dhe, se (iii) parashtruesi i kërkesës kishte derdhur në arkat e palës së paditur “NEPB Etem Trade” shumën prej 43, 536.55 euro pa bazë e që do të thotë se ajo është pasuruar në mënyrë të kundërligjshme. Gjykata Themelore po ashtu shtoi se pretendimi i palës së paditur për parashkrim të kërkesës në të holla është i pabazë sepse nuk bëhet fjalë për pagesë borxhi por për pasurim pa bazë ligjore duke iu referuar dispozitës së nenit 371 të LMD-së të vitit 1978.
12. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur “NEPB Etem Trade” paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim që ankesa në tërësi të aprovohet, të refuzohet në tërësi kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës si dhe të prishet apo ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që ankesa e palës së paditur të refuzohet e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i goditur i Gjykatës Themelore.
13. Më 9 nëntor 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykim [Ac. nr. 238/2016] aprovoi të bazuar ankesën e palës së paditur, ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës që të detyrohet pala e paditur që t’i paguaj shumën prej 43, 536, 55 euro me kamatë vjetore në lartësi prej 4%. Gjykata e Apelit konstatoi se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm sepse është bazuar në fakte jorelevante dhe interpretim të gabuar të dispozitave ligjore. Gjykata e Apelit, mes tjerash, shpjegoi: (i) se Gjykata Themelore gabimisht ka zbatuar dispozitat e të drejtës materiale, sepse në rastin konkret nuk zbatohet neni 371 por neni 374 i LMD-së sepse kërkesat për shpenzime parashkruhen brenda tre (3) vjetësh; (ii) se në rastin konkret parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadinë pas katër (4) vjetësh e tetë (8) muaj; (iii) se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për pasurim pa bazë sepse ekziston baza juridike dhe se transaksionet ndërmjet palëve janë kryer përmes faturave përkatëse dhe transaksioneve bankare; (iv) sipas nenit 67 të LMD-së, në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve nuk është e domosdoshme lidhja e ndonjë kontrate formale; (v) bazuar në nenet 27 dhe 67 të LMD-së është krijuar raporti kontraktual dhe ekziston baza juridike e transaksioneve prandaj nuk mund të

zbatohen dispozitat për pasurim pa bazë dhe, se (vi) sipas nenit 210.2 të LMD-së kusht themelor për pasurim pa bazë është që pasurimi të jetë pa bazë juridike, kurse në rastin konkret, baza juridike vërtetohet nga faturat përkatëse dhe transaksionet bankare ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

14. Më 21 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim që revizioni të aprovohet në tërësi kurse aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të ndryshohet dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Themelore.
15. Më 23 maj 2019, Gjykata Supreme me Aktgjykim [E.Rev.nr.9/2019] e refuzoi të pabazuar revizion e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.238/2016] të 9 nëntorit 2018. Gjykata Supreme i përvetësoi konstatimet e Gjykatës së Apelit lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave përkatëse të LMD-së për të përcaktuar çështjen e parashkrimit të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës dhe ligjshmërisë së kontratës ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E.Rev.nr.9/2019] i 23 majit 2019 është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
17. Për sa i përket shkeljes së nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Me vet faktin e marrjes së aktgjykimit, vlerësimi i kushtetutshmërisë i të cilit kërkohet me këtë ankesë, në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 210 para. 2 dhe 4 dhe nga neni 371 i LMD-së, parashtruesi i kësaj kërkesë vihet në pozitë të pabarabartë para ligjit me palën kundërshtare”*.
18. Për sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 210 par. 2 dhe 4 dhe nga neni 371 i LMD-së [...] ashtu që ai është marrë në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së”*.
19. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) që kërkesa e tij të shpallet e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe, (iii) të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së Apelit për rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

22. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*
23. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

24. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës nr. KI41/09, me parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14). Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E.Rev.nr.9/2019] të 23 majit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.
25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
26. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2, i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e Gjykatës së Apelit dhe asaj të Supremes janë nxjerrë në shkelje të neneve 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse gjykatat gabimisht kanë interpretuar dhe zbatuar dispozitat ligjore 210 (2) dhe 4 dhe 371 të LMD-së.
28. Gjykata në vijim, do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën Gjykata, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
29. Gjykata thekson se praktika e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi (shih rastet e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykimi i 4 gushtit 2017, paragrafi 38 dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
30. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës e ndërtoi rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve dhe interpretimin e gabuar të ligjeve, dhe më

specifikisht LMD-së. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).

31. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 37 dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 qershorit 2018, paragrafi 57).
32. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Ruisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 38 dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58).
33. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritetet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjedhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
34. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerret masa kur vëren se një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83 dhe gjithashtu, rastet e Gjykatës KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 40 dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 59).

35. Në rrethanat e rastit konkret, sipas parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kanë interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitat e LMD-së përkitazi me parashkrimin e kërkesëpadisë.
36. Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit kishte konstatuar: (i) se Gjykata Themelore gabimisht ka zbatuar dispozitat e të drejtës materiale, sepse në rastin konkret nuk zbatohet neni 371 por neni 374 i LMD-së sepse kërkesat për shpenzime parashkruhen brenda tre (3) vjetësh; (ii) se në rastin konkret parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadinë pas katër (4) vjetësh e tetë (8) muaj; (iii) se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për pasurim pa bazë sepse ekziston baza juridike dhe se transaksionet ndërmjet palëve janë kryer përmes faturave përkatëse dhe transaksioneve bankare; (iv) sipas nenit 67 të LMD-së, në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve nuk është e domosdoshme lidhja e ndonjë kontrate formale; (v) bazuar në nenet 27 dhe 67 të LMD-së është krijuar raporti kontraktual dhe ekziston baza juridike e transaksioneve prandaj nuk mund të zbatohen dispozitat për pasurim pa bazë dhe, se (vi) sipas nenit 210.2 të LMD-së kusht themelor për pasurim pa bazë është që pasurimi të jetë pa bazë juridike, kurse në rastin konkret, baza juridike vërtetohet nga faturat përkatëse dhe transaksionet bankare ndërmjet palëve ndërgjyqëse.
37. Gjykata po ashtu i referohet pjesës relevante të aktgjykimit të Gjykatës Supreme, që përcakton:

“Gjykata Supreme e pranon si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditëses, kjo për faktin se mes palëve është krijuar raporti i kontraktuar, paditësi ka kontraktuar gojarisht me të paditurën dhe janë marrë vesh që e paditura ta furnizojë atë me material të nevojshëm për zhvillimin e punimeve rreth ndërtimit të rrugës në fjalë, në bazë të kësaj kontrate, e paditura ka dërguar një pjesë të materialit, në bazë të faturës dhe transaksioneve bankare. Sipas nenit 67 të LMD-së, në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve nuk është e domosdoshme lidhja e ndonjë kontrate formale. Në rastin konkret në kuptim të nenit 26 dhe 67 të LMD-së, është krijuar raporti kontraktual dhe ekziston baza juridike e transaksioneve [...] përderisa ka ekzistuar njëherë baza juridike në raportin ndërmjet palëve nuk mund të ketë pasurim të pabazë për këtë arsye është i drejtë qëndrimi i juridik i gjykatës së shkallës së dytë se në këtë as nuk mund të vendoset sipas institutit të pasurimit të pabazë, siç është rregulluar me nenin 210 par. 1, 2 dhe 4 të LMD-së (1978). Kjo dispozitë mund të aplikohet vetëm në rast se përmbushen në mënyrë kumulative të gjitha elementet e nenit 210 par. 2 të LMD-së. Kusht themelor për pasurim të pabazë sipas kësaj dispozite është që pasurimi të jetë pa bazë juridike, në këtë rast ky kusht nuk është plotësuar dhe për rrjedhojë gabimisht është zbatuar nga gjykata e shkallës së parë [...] në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se, raporti i fundit kontraktual ndërmjet palëve ndërgjyqëse ka qenë me datën 27.12.2008, ndërsa paditësi me datë 23.09.2013 ka parashtruar propozimin e konsideruar padë për pagimin e borxhit në shumën prej 43,536,55 €, nga çka rezulton se kërkesa e paditësit nga marrëveshja e lartpërmendur për qarkullimin e mallit, është parashkruar sepse që nga raporti i fundit ndërmjet palëve e deri te data e parashtrimit të padisë kanë kaluar mbi 4

vite e 8 muaj. Andaj, gjykata e shkallës së parë gabimisht kanë konstatuar se borxhi kontestues rezulton nga pasurimi i pabazë për të cilat kërkesa nga kjo bazë juridike kishte për tu aplikuar afati i përgjithshëm 10 vjeçar i parashkrimit sipas nenit 371 të LMD-së vjetër [...] në revizion parashtrohet në mënyrë të pabazuar se gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale nga neni 374 të LMD-së (1978) pasi që kërkesat e ndërsjella të subjekteve mbi qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve nuk kanë të bëjnë me persona shoqëror-juridik por me kërkesat e personave fizik. Ky pretendim nuk qëndron për faktin se në rastin konkret kontesti lidhur me kërkesat e ndërsjella të subjekteve mbi qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve nuk zhvillohet në mes personave fizik ashtu si pabazë theksohet në revizion pasi që paditësi ashtu edhe e paditura janë të regjistruara si shoqëri tregtare në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kuvendit të Kosovës, që kanë përgjegjësi për të gjitha detyrimet e imponuara me ligje ose me kontratë.”

38. Gjukata më tej rithekson se, në parim, interpretimi i ligjit është kompetencë e gjykatave të rregullta. Për më tepër, “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës nr. KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
39. Gjukata gjithashtu thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjukata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
40. Për sa i përket drejtësisë procedurale, Gjukata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës Nr. KI118/17, Parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, mutatis mutandis, rastin Garcia Ruiz kundër Spanjës, GJEDNJ nr. 30544/96 i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
41. Për sa i përket pretendimit për shkelje të barazisë para ligjit siç garantohet me nenin 24 të Kushtetutës, Gjukata vëren se bazuar në praktikën gjyqësore të

GJEDNJ-së, përgjithësisht, në mënyrë që një çështje të ngrehet nën nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ-së duhet të ekzistojë dallimi në trajtim ndërmjet personave në situata të ngjashme ose të krahasueshme (shih rastin e GJEDNJ-së, *X dhe të tjerët kundër Austrisë*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 2013, paragrafi 98). Megjithatë, jo çdo dallim në trajtim përbën shkelje të nenit 14. Dallimi në trajtim do të jetë diskriminues nëse i mungon justifikimi objektiv apo i arsyeshëm; thënë ndryshe, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse mungon marrëdhënia e arsyeshme ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimit që synohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ-së, *Guberina kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 22 marsit 2016, paragrafi 69 dhe referencat tjera të përmendura aty).

42. Në rastin konkret, gjykatat e rregullta kanë shpjeguar se cilat dispozita ligjore duhet të interpretohen dhe zbatohen për zgjidhjen e rastit të parashtruesit të kërkesës, çka është raport juridik ndërmjet palëve ndërgjyqëse, çka quhet kontratë në raportin juridik ndërmjet palëve ndërgjyqëse dhe se si është parashkruar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës.
43. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të provojë se është trajtuar ndryshe në raport me persona të tjerë në situata të ngjashme apo të krahasueshme, siç kërkohet me nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së.
44. Gjykata po ashtu vëren se pretendimi për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës vetëm sa është përmendur nga parashtruesi i kërkesës pa ofruar ndonjë provë për ta mbështetur pretendimin në fjalë.
45. Gjykata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës për barazi para ligjit apo edhe për shkeljen e të drejtave në mbrojtje gjyqësore të tyre (shih rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
46. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 5 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

